

**ARDIAN MUHAJ**

**PËRCAKTIMI I KUFIRIT VENETO-OSMAN  
NË SANXHAKUN E SHKODRËS NË FUNDIN E SHEK. XV  
SIPAS TRAKTATEVE NDËRKOMBETARE TË KOHËS**

*E drejta ndërkombëtare pavarësisht faktit se është përgjithësuar dhe bërë e përbotshme në kohët moderne, i ka zanafillat shumë më herët. Parimet bazë të saj nisën të formësohen që në Mesjetën e Vonë, pra që në shek. XIV-XV.<sup>1</sup> Në formësimin e të drejtës ndërkombëtare, traktatet e paqes kanë luajtur një rol të dorës së parë. Shumë parime bazë që rregullonin dhe akoma rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet shteteve kanë hyrë dhe janë përpunuar në traktatet e paqes që nga periudha e Rilindjes e këtej.<sup>2</sup> Një këndvështrim i tillë i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe i zhvillimeve gjeopolitike në trojet shqiptare ka munguar. Kjo nuk ka të bëjë thjesht me rastin shqiptar por është një trajtim që ndërmerret rrallë në përgjithësi në studimet medievalistike edhe jashtë.<sup>3</sup> Ky artikull është një përpjekje për të këndvështruar historinë politike të një pjese të rëndësishme të trojeve shqiptare në shek. XIV-XV përmes të drejtës ndërkombëtare të kohës, duke përfshirë faktorët politikë veprues dhe formësues të dinamikës dhe gjeografisë politike të zonës në fjalë, pra sundimtarët shqiptarë, shtetin osman dhe shtetin e Venedikut.*

<sup>1</sup> Sipas Karl Heinz Ziegler, "The International Law of Europe since the Middle Ages", *Baltic Yearbook of International Law*, vol. 7, Leiden: 2007, f. 25. Public International Law, siç e quajmë shpesh "të drejtën e kombeve", i korrespondon në frëngjisht asaj që quhet "droit des gens" dhe në gjermanisht "Volkerrrecht", që është një përkthim nga latinishtja "ius gentium".

<sup>2</sup> Randall Lesaffer, "Introduction", *Peace Treaties and International Law in European History From the Late Middle Ages to World War One*, edited by Randall Lesaffer, Cambridge University Press, 2008, f. i.

<sup>3</sup> Karl-Heinz Ziegler, "The peace treaties of the Ottoman Empire with European Christian powers", në R. Lesaffer, ed. *Peace Treaties and International Law in European History...*, f. 338, e konsideron shtetin osman si të vetmen fuqi jo të krishterë e cila që prej mesjetës e deri në fillimin e shek. XX, ka qenë gjithnjë një faktor i përhershëm i sistemit politik evropian.

Ekspansioni venedikas në bregun shqiptar zë fill në dekadën e fundit të shek. XIV pothuaj një dekadë mbas luftës së Chioggia-s, në fillim të viteve 1380 gjatë së cilës u kërcënua vetë ekzistenca e Republikës së Venedikut. Gjatë kësaj lufte, ndërkohë që forcat gjenoveze e hungareze kishin mbërritur deri në muret e qytetit të Venecies, osmanët tashmë gjendeshin në kufijtë e trojeve shqiptare, ku Balshajt që ishin afirmuar si pushtet politik në veri, rivalizonin me Topiajt. Në një situatë të tillë sundimtari i Durrësit, Karl Topia kërkoi ndihmën e osmanëve. Në Savër të Myzeqesë, në shtator 1385, u zhvillua një betejë e cila pati një rëndësi të madhe për zhvillimet e mëvonshme politike në trojet shqiptare. Në këtë betejë, Topia me aleatët e tij osmanë doli fitues, dhe Balsha II u vra. Si pasojë, sundimtarët shqiptarë megjithë pasardhësin e Balshës II, njohën suzerenitetin osman.<sup>4</sup>

Ndërkohë që ndërmjet betejës së Savrës dhe betejës së Kosovës, prania osmane u bë gjithnjë e më e fortë në trojet shqiptare, venedikasit akoma nuk i kishin hedhur sytë drejt Shqipërisë. Veç Balshajve e Topiajve edhe Dukagjinët që sundonin në prapatokën e Lezhës më 1387 në një letër që u dërgojnë raguzanëve njoftojnë paqen me osmanët.<sup>5</sup> Megjithatë, i çliruar nga kërcënimi në Itali, Venediku nuk do të vonojë të hedhë shikimin drej brigjeve shqiptare. Në tetor 1387, Venediku dërgoi një emisar tek Murati I me sa duket për të theksuar të drejtat e vjetra venedikase në Durrës dhe në të njëjtën kohë filloi bisedimet me Karl Topinë për të marrë qytetin, të cilin e mori më 1392 pas vdekjes së Gjergj Topisë.<sup>6</sup> Kështu duke marrë edhe Lezhën, Shkodrën e Drishtin më 1396 Venediku kompensoi disi humbjen e Dalmacisë më 1358, konfirmuar në

<sup>4</sup> Halil Inalcik, "Timariotes chretiens en Albanie au XVe siècle, d'après un registre de timars ottoman", në *Mitteilungen des Österreichischen Staatsarchivs*, 4, Vjenë: 1951, f. 120, 122.

<sup>5</sup> *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, collegerun et digesserunt Ludovicus de Thalloczy, Constantinus Jirecek, et Emilianus de Sufflay, Vjenë: 1918, vol. II, f. 99, nr. 413.

<sup>6</sup> Më 1387, Topia u ofroi gjenovezëve qytetin për ta mbrojtur nga osmanët, pasi Venediku e kishte refuzuar më herët kërkesën e tij. Alain Ducellier, "Genesis and failure of the Albanian State in the fourteenth and fifteenth centuries", në *L'Albanie entre Byzance et Venise, Xe-XVe siècles*, Variorum Reprints, London: 1987, n. XII, f. 12. Oferta e Topisë u diskutua në Senat më 31 mars 1387, ku megjithatë nuk thuhet se Topia ua ofroi gjenovezëve por "të tjerëve". G. Valentini mendon se "të tjerët" ishin Napoli ose Hungaria. Giuseppe Valentini, "Dell' amministrazione veneta in Albania" në *Venezia e il Levante fino al secolo XV*, a cura di Agostino Pertusi, Firenze: 1973, f. 850.

paqen e Torinos më 1381.<sup>7</sup> Kjo praktikisht solli legjitimimin e pranisë osmane në trojet shqiptare në sundimet e Topiajve si aleatë dhe në ato të Balshajve si të mundur, pra vasalë. Njëkohësisht me ekspansionin territorial venedikas në Ballkan ndodh edhe ekspansioni i Sinjorisë në Italinë Veriore.<sup>8</sup> Po ashtu në More, Venediku mori Nauplian (1388), Lepantin (1393), Argosin (1394), Patrasin (1408), Selanikun (1423).<sup>9</sup>

Si vasal i osmanëve Gjergj Strazimir Balsha (1385-1403) që erdhi në pushtet pas vrasjes së Balshës II, kërkoi ndihmën e tyre në konfliktin me boshnjakët. Qefalia Shahin (Lala Shahin), ndërmori një sërë sulmesh të sukseshme në Bosnjë, derisa u mund në një betejë afër Trebinjës në gusht 1388. Balsha, madje, u akuzua nga boshnjakët për një aleancë të fshehtë, me osmanët. Nga ardhja e tyre si aleatë të ftuar nga princat rivalë shqiptarë më 1385, në dekadën e fundit të shek. XIV, për herë të parë shteti osman mori nën kontroll disa kështjella me rëndësi strategjike në brigjet e Adriatikut. Më 1393, osmanët morën në dorëzim në rrethana akoma jo plotësisht të sqaruara qytetet e Shkodrës, Drishtit dhe Lezhës. Po në vitet 1390, osmanët morën për herë të parë edhe Krujën deri në afërsi të Durrësit.<sup>10</sup> Çdo analizë e vendosjes së sundimit osman në

<sup>7</sup> Zrinka Pešorda-Vardić, "The Crown, the King and the City: Dubrovnik, Hungary and the Dynastic Controversy, 1382-1390", në *Dubrovnik Annals*, 10, Dubrovnik: 2006, f. 8. Raguzasit kërkonin vazhdimisht nga mbreti i Hungarisë të mos lejojë që Venediku t'i ndalojë në tregtinë e tyre në Zetë, sepse që nga paqja e Zarës e vitit 1358 dhe e konfirmuar në paqen e Torinos të vitit 1381, venedikasit kishin hequr dorë prej bregut adriatik nga Kuarneri deri në Durrës. "toti Dalmacie a medietate scilicet Quarnarii usque ad confines Duracii". V. Bogišić et K. Jireček, *Liber statutorum civitatis Ragusii compositus anno 1272: cum legibus aetate posteriore insertis atque cum summariis, adnotationibus et scholiis a veteribus juris consultis ragusinis additis*, Zagreb: 1904, f. XXVI.

<sup>8</sup> Treviso (1387), Padova (1405), Verona (1402), Vicenza (1404), Belluno (1420), Brescia (1426), Bergamo (1428), Rovereto (1416). John E. Law, "The Venetian Mainland State in the Fifteenth Century," në *Transactions of the Royal Historical Society*, 6<sup>th</sup> series, II, London: 1992, f. 153-174.

<sup>9</sup> Selaniku u dha nga perandori bizantin për 50 mijë dukatë. Charles Diehl, "The Economic Decline of Byzantium", në *The Economic Decline of Empires*, edited by Carlo M. Cipolla, London: Methuen, 1970, f. 101. Osmanët e konsideronin Selanikun të vetin pasi kishte qenë nën suzerenitetin e tyre ndërmjet viteve 1387-1407. Për pasojë, e panë aneksimin nga Venediku si një deklaram luftë dhe më 1430 ua morën venedikasve. J. R. Melville-Jones, *Venice and Thessalonica 1423-1430: The Venetian Documents*, Padova: 2002, f. 147-175.

<sup>10</sup> Në vitin 1392, në një dokument venecian thuhej se kufijtë e Turqisë ishin shtrirë deri në rrethinat e Durrësit (quia Turchorum confines sunt propinqui territorio Durachii).

Shqipëri dhe e implikimeve në kuadër të rivalitetit mes osmanëve dhe venedikasve e ka zanafillën në këtë kohë. Statusi ligjor në bazë të së drejtës ndërkombëtare të kohës është i një rëndësie parësore për të kuptuar zhvillimet e mëvonshme politike në kuadër të rivalitetit veneto-osman në Shqipëri. Në këtë aspekt edhe pse osmanët e mbajtën Shkodrën, Drishtin, Lezhën, Dejën e Shëngjin në Bunë vetëm për një periudhë të shkurtër, nga viti 1393 deri në vitin 1396, kjo do të kishte pasoja të rëndësishme për dinamikën e rivalitetit mes Venedikut e osmanëve në trojet shqiptare për dy shekujt pasues. Në vitin 1394, Gjergj Strazimir Balsha i ofronte Venedikut zotërimin e Shkodrës, por Sinjoria e refuzoi ofertën edhe për arsyen se Shkodra ndërkohë ishte në duart e osmanëve.<sup>11</sup> Ky refuzim i venedikasve për të marrë Shkodrën për shkak të qënies së saj nën sundimin osman, tregon se kur ata e morën dy vite më vonë, duhet ta kenë bërë jo vetëm duke kompensuar Balshën por edhe duke marrë pëlqimin dhe lejen e osmanëve. Venedikasit tregoheshin gjithnjë të kujdesshëm që paralelisht me marrjen e qyteteve të ofruara nga zotërit lokalë me kushte favorizuese, të arrinin marrëveshje me osmanët për legjitimimin dhe garantimin e sigurisë së tyre.<sup>12</sup> Në mesin e Shqipërisë Venedikase, Shkodra, Lezha dhe Drishti kanë një status të ndryshëm nga zotërimet e tjera venedikase mbasi që në fillim merren nga Venediku si zotërimet të përkohshme dhe si territore osmane të cilat Venediku i mbajti duke paguar një shumë vjetore zotëruesve *de jure* të tyre, osmanëve.<sup>13</sup> Pikërisht për këtë Venediku nuk mundi të krijojë një

*Acta et diplomata res Albaniae...*, vol. II, f. 124, nr. 488. Mbi marrjen e Krujës gjatë sundimit të Bajazitit shih edhe Halil Inalcik, *Süret-i defter-i Sancak-i Arvanid*, Ankara: 1954, f. XIV; Luan Malltezi, "Rreth historisë së kështjellës së Krujës dhe zonës së saj në vitet 1392-1415", në *Studime historike*, nr. 2, Tiranë: 1989, f. 157-175.

<sup>11</sup> "quod dictus locus Scutari presentialiter est in manibus Turchorum". *Acta et diplomata res Albaniae...*, II, dok. nr. 513, f. 133.

<sup>12</sup> Frederic C. Lane, *Venice: A Maritime Republic*, Baltimore: Johns Hopkins University Press, 1973, f. 198.

<sup>13</sup> Në një dokument të vitit 1392 thuhet se Gjergj Strazimiri dhe dikush nga gjaku i tij, që ka të ngjarë të bëhet fjalë për të birin, u detyruan t'u jepnin turqve Ulqinin, Shkodrën, si dhe lokalitete të tjera të tij si kusht për t'i lënë të lirë e të qetë. Mirëpo marrja e Ulqinit nga osmanët nuk dokumentohet. Duket se në vend të Ulqinit të jetë bërë fjalë për Drishtin, pasi më 1396, Balsha u dorëzon venedikasve Shkodrën e Drishtin, por jo Ulqinin. *Acta et diplomata res Albaniae...*, II, dok. nr. 555, f. 148; Konstantin Jirecek, "Skutari und Seine Gebiet im Mittelalter", në *Illyrisch-Albanische Forschungen*, hrsg. Ludwig von Thallöcszy, München-Leipzig: 1916, Band I, f. 94-

strategji efektive mbrojtëse në këtë zonë.<sup>14</sup> Pra kur venedikasit marrin nga Gjergj Strazimir Balsha pikërisht këto tri qytete, ata u kujdesën edhe për të marrë pëlqimin e osmanëve, vasal i të cilëve ishte Balsha dhe pa pëlqimin e të cilëve nuk mund të kishte vlerë ligjore marrja e tyre.

Mbas disfatës së Ankarasë më 1402 shumë prej zotërinjve shqiptarë të cilët deri atëherë ishin nën suzerenitetin osman, si Gjon Kastrioti, Kojë Zaharia, Niketa Thopia njohën suzerenitetin venedikas. Një vit më vonë më 1403 vdiq Gjergj Strazimir Balsha. Vendin e tij e zuri i biri, Balsha III. Ngaqë ishte i ri në moshë, ndikimi i së ëmës mbi të ishte i madh. Jelena ishte motra e mbretit serb Stefan Lazareviç dhe njëkohësisht kunata e Bajazitit I. Pra, Bajaziti I dhe Gjergj Strazimir Balsha të martuar të dy me motrat e Lazareviçit, ishin baxhanakë dhe në këto lidhje familjare mund të kërkojmë edhe një nga arsyet e shumta të ndërlikimit dhe shpjegimit të marrdhënieve në këtë zonë. Venediku e shfrytëzoi disfatën e Bajazitit I dhe vdekjen e kunatit të tij Gjergj Strazimir për të futur në dorë zotërimet e Balshajve. Kështu mori Ulqinin, Tivarin e Budvan. Por nuk vonoi dhe Balsha III i mbështetur edhe nga osmanët e forcuar, nisi luftën e gjatë e të përgjakshme për rimarrjen e sundimeve të tij. Në korrik 1412 porositet ambasadori që shkonte tek Sulltani për ta informuar se Balsha nuk pushon së trazuari qytetet e Sinjorisë në Shqipëri, prandaj para se të jepte paratë e tributit t'i kërkohej atij “me ngulm e miqësisht... që ai të marrë masa të rrepta dhe të tilla që i thëni Balshë të na kthejë qytetin e sipërthënë”.<sup>15</sup>

Pikërisht zotërimet e Balshajve të marra më 1405 nga Venediku do të kenë një status të ndryshëm nga ato të marra më 1396 dhe për pasojë

124; “Shkodra dhe rrethinat e saj në Mesjetë”, përkthyer nga Edmond Malaj, në *Hylli i Dritës*, nr. 4, Shkodër: 2011, f. 94.

<sup>14</sup> Mbi fillimin e pranisë venedikase në Shqipëri: G. Valentini, *Dell'amministrazione veneta in Albania...*, f. 844-910; Luan Malltezi, *Qytetet e bregdetit shqiptar gjatë sundimit venedikas (1392-1478): aspekte të jetës së tyre*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1988; Edmond Malaj, *Drishti. Historia dhe fizionomia e një qyteti mesjetar shqiptar*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti 4i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2015, f. 51-64; Oliver Jens Schmitt, *Arbëria Venedike (1392-1479)*, Tiranë: Fjala, 2014, f. 201-237.

<sup>15</sup> ASV, *Senato. Deliberazioni miste*, registro XLIX/ 129-131v. Shprehja të kërkosh miqësisht (amicabiliter requiras) nënkupton se tributi nuk përfshinte edhe garancinë për Tivarin dhe qytetet e tjera të marra më 1405, përndryshe do të ishte kërkuar reduktimi i shumës ose respektimi i marrëveshjes. Në këtë rast sulltani kërkohet thjesht si ndërmjetës dhe jo si i lidhur simbas ndonjë marrëveshjeje.

edhe një histori të ndryshme. Territoret e Balshës, të marra nga osmanët më 1393 dhe nga venedikasit më 1396, do të rimerren nga osmanët më 1478-1479, mbasi venedikasit i kishin marrë prej tyre me titull të përkohshëm dhe kundrejt një pagese vjetore. Territoret e tjera, pra Tivarin, Ulqinin dhe Budvën, osmanët nuk ia morën Balshës asnjëherë, dhe prandaj ua njohën venedikasve të cilët ia morën direkt Balshës më 1405, si zotërim të marra në luftë dhe si të tilla nuk patën pretendime ndaj tyre gjatë gjithë shek. XV e pjesës më të madhe të shek. XVI.<sup>16</sup> Edhe në marrëveshjen e paqes të vitit 1412, Venediku ia njehej Balshës titullin sundues i Zetës, por jo i Shqipërisë apo i Shkodrës.<sup>17</sup> Gjithë kundërshtia mes tyre kufizohej tek territoret e marra më 1405. Nga lufta e Balshës, Venediku ishte gati të negociojë dhënien e Ulqinit dhe Budvës, me kusht që të gjitha vendet e tjera, të cilat i qenë shitur dhe dhënë zotërimit tonë nga vetë ai zoti Gjergj babai i tij, t'i mbeteshin Sinjorisë “përgjithnjë pa asnjë kundërshtim apo trazim”.<sup>18</sup> Për këtë arsye në diskutim, gjatë luftës veneto-osmane të viteve 1463-1479 nuk ishin as Durrësi i marrë nga venedikasit direkt nga zotëruesit e tij Topiajt, dhe as Ulqini, Tivari e Budva të marrë nga Venediku direkt nga Balshajt më 1405, por vetëm territoret e marra fillimisht nga osmanët më 1393 dhe më pas të ceduara, Venedikut më 1396, pra Shkodra, Drishti, Shirgji. Më 1386 Karl Topia ua afroji Durrësin venedikasve por oferta nuk u pranua. I biri, Gjergj ia dorëzoi qytetin pak kohë para vdekjes së tij, Republikës (gusht 1392). Venedikasit e patën Durrësin nën zotërim nga viti 1392 deri në vitin 1501. Topiajt vazhdonin të garantonin paqen e sigurinë e zonës përreth

<sup>16</sup> Fillimisht venedikasit morën Ulqinin, më 24 korrik 1405, në kundëroftensivën e suksesshme kundër trupave të Balshës që kishin rrethuar Shkodrën. Më pas nuk vonoi, Tivari dhe Budva u morën nga venedikasit në gjysmën e parë të gushtit përdërisa më 18 gusht Senati caktoi qeveritarët respektivë për secilin prej tyre. Giuseppe Gelchich, *La Zedda e la dinastia dei Balsidi. Studi storici documentati*. Split, G. Laghi, 1899, f. 237, 240.

<sup>17</sup> “*magnificum et potentem dominum Balsam Strazimiri... dominum Zente*”. ASV, Comemoriale X. 132, 26 nëntor 1412; *Acta archivi Veneti spectantia ad historiam Serborum et reliquorum Slavorum meridionalium*, collegit et transcripsit Janko Šafařík, Beograd, 1860, f. 499.

<sup>18</sup> “Et quod omnia alia loca, qui vendita fuerant, et data dominio nostro per eumdem dominum Georgium ejus patrem, debeant nobis expedite et sine ulla contradictione uel molestia, libere dum omnibus eorum juribus districtibus pertinentis et confiniis in perpetuum remanere”. ASV, Comemoriale X, 132, 26 nëntor 1412, *Acta archivi Veneti spectantia ad historiam Serborum et reliquorum Slavorum meridionalium...*, f. 500-501.

qytetit dhe shfrytëzimin e patrazuar të kriporeve. Deri në vdekjen e Niketë Topias kjo detyrë kryhej nga ai në këmbim të 100 dukatëve në vit dhe dy veshjeve. Pastaj e drejta për të sunduar në viset e tij i takoi turkut Amur Beu. Prandaj Senati urdhëron bajlkapedanin e Durrësit të dërgojë ambasadorë të vet, nga qytetarët e Durrësit tek Amur Beu, që t'i jepet atij ai provision vjetor që i jepej Niketës. Mirëpo, theksohet qartë që kjo marrëveshje të bëhej, “në emër të bashkisë së Durrësit pa përmendur për këtë gjë në asnjë mënyrë zotërimin tonë”.<sup>19</sup> Në këtë grup qytetesh që osmanët kërkonin t'u riktheheshin në luftën e viteve 1463-1479 përfshiheshin edhe Lezha e Kruja, të cilat kishin rënë nën suzerenitetin osman gjithashtu gjatë periudhës së Bajazitit I, pra në vitet 1390. Kruja u mor nga venedikasi Marko Barbadiku përmes martesës me Helenën, të bijën e Karl Topisë. Me anë të një marrëveshjeje të 28 gushtit 1393, Venediku i bindi Barbadikun dhe Helenën ta qeverisnin Krujën si vasalë të saj. Venedikasin pohonin se sipas dëshmimeve të besueshme as Barbadiku dhe as Helena nuk zotëronin ndonjë të drejtë ligjore mbi Krujën.<sup>20</sup> Ndërsa ato që i ishin marrë Balshës gjatë periudhës së dobësimit dhe anarkisë osmane nuk vihehin në diskutim nga osmanët sipas parimit të *uti possidetis*.<sup>21</sup>

Këtë e shpjegon më së miri rasti i territoreve më të hershme shqiptare të marra nga Venediku në Shqipëri, që ishin Butrinti dhe Sajadha. Në qershor 1387 venedikasin morën qytetin e Korfuzit dhe Butrintin, kurse në shtator Sajadhën. Të dy këto u vendosën nën juridiksionin e bailiut venecian të Korfuzit.<sup>22</sup> Mirëpo, pjesa më e madhe e ishullit vazhdonte të ishte nën suzerenitetin e sundimtarit legjitim

<sup>19</sup> “*nomine communitatis Durachij non nominando in hoc ullo modo nostrum dominium*”. ASV, *Deliberazioni miste*, registro LI/20, 5 maj 1415.

<sup>20</sup> (*ipsum nec dominam Helenam consortem suam non habere aliquid jus in castro Croy*). *Acta et diplomata res Albaniae...*, II, f. 121, nr. 507. Një vit më vonë Barbadiku kishte shkuar tek sulltan Bajaziti për t'u bërë vasal i tij (*qui videtur ivisse ad inclinandum Basaito*) dhe pasi kishte marrë mandatin e Bajazitit për të aneksuar të gjitha territoret, deri në kufijtë e Durrësit, kishte filluar të nxiste popullin në kryengritje kundër Venedikut (*in maximum destructionem patrie, nam iam incept subvertere totum populum*). *Acta et diplomata res Albaniae...*, II, f. 135, nr. 518.

<sup>21</sup> Që në fillimin e shek. XV osmanët përdorën parimin ligjor të *uti possidetis* si bazë për vendosjen e marrëdhënieve paqësore në rajon. V. L. Ménage, “Seven Ottoman Documents from the Reign of Mehmed II”, në *Documents from Islamic Chanceries*, edited by S.M. Stern, Oxford: Bruno Cassirer, 1965, f. 102.

<sup>22</sup> Mbi arsyetimet e pushtimit venedikas të Korfuzit shih Eugenio Bacchion, *Il dominio veneto su Corfù (1386-1797)*, Venezia: 1956, f. 26-31.

Ladislav, Mbreti i Napolit. Edhe pse një përfaqësi e aristokracisë korfiote e dorëzoi formalisht ishullin tek Venediku më 1394, Sinjoria nuk e mori nga sundimtari i ligjshëm. Vetëm nga fillimi i vitit 1403, Venediku e bleu zyrtarisht ishullin nga Ladislasi.<sup>23</sup> Butrinti qëndroi nën sundimin venedikas më shumë se cdo territor tjetër shqiptar, pikërisht sepse edhe u mor më herët prej tyre. Studiuesi Pëllumb Xhufi, me të drejtë e thekson rëndësinë e traktateve dypalëshe në garantimin e paqes mes palëve duke e ilustruar me një rast të vitit 1502 kur sanxhakbeu i Vlorës, Mustafa Pasha gjatë marshimit për në Leukadë, u ndal afër Butrintit venecian dhe për një çast vendosi ta pushtojë atë. Por, u detyrua të heqë dorë nga kjo ndërmarrje, për të cilën nuk kishte marrë autorizim nga qendra. Madje, edhe dyshimi i autorit se kundrejt planeve osmane për fortifikimin e Porto Palermos, venecianët të kenë shfrytëzuar ndonjë nen të traktateve të paqes mes Venedikut e Portës, që pas çdo gjase e shpallte Porto Palermon dhe pika të tjera të bregdetit jonian, si zonë e demilitarizuar, duke na kujtuar “se mirë apo keq, Porta e Lartë i respektoi traktatet me Republikën e Venedikut”, del plotësisht i mbështetur nga dokumentacioni.<sup>24</sup> Pra, edhe pse krejt territoret përreth kishin rënë në duart e osmanëve që në shek. XV, Butrinti qëndroi në duart e zotërve të vet më të hershëm, venedikasve për më se tre shekuj, nga viti 1387 deri në luftën e Kretës në 1645-1669, e madje u rimor prej tyre për një kohë gjatë luftës veneto-osmane të viteve 1684-1699.<sup>25</sup> Më 1716, venedikasit sulmuan dhe ia dolën ta rimarrin Butrintin dhe kjo u rikonfirmua nga osmanët edhe në paqen e nënshkruar në Passarowitz, në 21 korrik 1718.<sup>26</sup>

Venediku e konfirmoi marrëveshjen për çështjen e zotërimeve të veta në Shqipëri me suzerenin e tyre, Emirin Sulejman më 29 shtator 1409, duke vazhduar t’i paguajë osmanëve një tribut vjetor. Më 1411 ndër

<sup>23</sup> R. Gertwagen, *The Island Corfu in Venice's policy in the Eastern Mediterranean in the Early Modern Period (the 14th and first half of the 15th Centuries)*, International Journal of Maritime History, vol. 19/1, Baltimore: 2007, f. 181-190. Më 1401 Venediku mori Lepantin si edhe Patrasin nga peshkopi i qytetit dhe miratoi pagesën e tributit ndaj osmanëve për njohjen nga ata të zotërimit të Patrasit dhe Lepantit. P. Topping, “The Morea, 1364-1460”, in *A History of the Crusade, The fourteenth and fifteenth Centuries*, edited by H.W. Hazard, vol. III, The University of Wisconsin Press: 1975, f. 161-163.

<sup>24</sup> Pëllumb Xhufi, *Árbërit e Jonit. Vlora, Delvina e Janina në shek. XV-XVII*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Onufri, 2016, f. 155.

<sup>25</sup> *Po aty*, f. 166.

<sup>26</sup> *Po aty*, f. 170; E. Bacchion, *Il dominio veneto su Corfù ...*, f. 186.

udhëzimet që i jepeshin ambasadorit venedikas, që shkonte tek sulltani Musa Çelebiu kërkohej që sulltani i ri të përfshinte në traktat, Negropontin dhe qytetet e vendet e tjera të Greqisë deri në Lepant si edhe zotërimet në të gjitha qytetet e Shqipërisë, me rrethet e tyre që Venediku mbante në atë kohë. Ai duhej t'i premtonte sulltanit të ri të njëjtin tribut sikur të mëparshmit, përkatësisht për Lepantin 100 dukatë në vit, për vendet që Venediku mbante në Shqipëri një mijë dukatë dhe për Patrasin 500 dukatë në vit.<sup>27</sup> Edhe marrëveshja e paqes e nënshkruar më 12 gusht dhe 3 shtator respektivisht mes Venedikut dhe sulltan Musait sundues i Greqisë (domino Grecie) që konfirmonte paqen e bërë nga i vëllai, thekson që në artikullin e parë se kështjellat, qytetet dhe juridiksionet e tyre në Shqipëri, që venedikasit i mbajnë në duart e tyre, të cilat qenë të Gjergj Strazimitit dhe Gjergj Balshës, “t'i mbajnë ato pa pengesën e ndokujt dhe ata për vendet në fjalë t'i japin zotërisë sime njëmijë dukate ari”.<sup>28</sup> Në paqen e vitit 1419 me sulltan Mehmetin I, e cila ishte e ngjashme me atë të vitit 1411,<sup>29</sup> Sulltani njohu zyrtarisht suzerenitetin e Venedikut mbi 38 kështjella e qytete, duke përfshirë edhe Shkodrën, Drishtin, Lezhën Negropontin, Modonin, Koronin, Korfuzin, Lepanton dhe Durrësin<sup>30</sup> Mirëpo nga të gjitha këto qytete, Venedikut i duhej të paguante haraç vjetor për katër prej tyre, Shkodrën, Drishtin, Lezhën dhe Lepanton.<sup>31</sup> Ky haraç vjetor vazhdon të konfirmohet edhe në

<sup>27</sup> Më 31 gusht 1411, Sulltani konfirmon marrjen e 1100 dukatëve për haraçin e vendeve që mbajnë në Shqipëri dhe për Lepantin. “*per lo censo chi proferse dar per i luogi e castelli itien in Albania, che fo de balsa, e per Nempato*” dhe thekson se kjo shumë është për vitin 1411, dhe jemi të larë deri në fund të gushtit të vitit 1412. ASV, Comemoriali X/113 (118)v.

<sup>28</sup> Mbi çështjen e zotërimeve të Balshës, bie në sy që sulltani thjesht ia konfirmon periodikisht mbajtjen e tyre Venedikut. “*li casteli, i luogi e terre iurisdicion habitation de castelli e terre le qual tien veniciani in le mani de quelli de Albania i qual fo de zorzi strazimir et de zorzi balsa, che siano nouiter et senza dano azo che habiano et tegnano quelli senza impazo de persona alguna*”. ASV, Comemoriali X/113 (118)v.

<sup>29</sup> Denis Romano, *The Likeness of Venice. A Life of Doge Francesco Foscari 1373-1457*, Yale University Press. New Haven and London: 2007 f. 16.

<sup>30</sup> Ricardo Predelli, *Diplomatarium veneto-levanticum sive acta et Diplomata res venetas, graecas illustrantia pars II, 1351-1454*, n. 172, f. 318-19.

<sup>31</sup> Kenneth M. Setton, *The Papacy and the Levant (1204 - 1571). The fifteenth century*, vol. II, Philadelphia: American Philosophical Society, 1978, f. 8.

marrëveshjet e mëvonshme, duke filluar nga ajo e vitit 1430, pas marrjes së Selanikut nga osmanët.<sup>32</sup>

Edhe pse Venediku pranonte pagesën e tributit për mbajtjen e Shkodrës, Drishtit, Lezhës dhe Patrasit e Lepantit në Greqi, ai synoi mbajtjen me çdo kusht të supremacisë detare në Adriatik dhe Egje. Pikërisht, përplasja e parë ushtarake mes Venedikut dhe osmanëve shënohet në det, kur një flotë veneciane korri një fitore të çmuar kundër osmanëve afër Galipolit.<sup>33</sup> Gjatë këtij konflikti të parë osmanët morën Antaljen dhe qytetin e Vlorës më 1417.<sup>34</sup> Në se marrim parasysh se ekspansioni i të dy këtyre fuqive në Shqipëri ishte bërë pa rezultuar në përplasje forcash, kjo do na sjellë tek një veçori e rëndësishme e marrëdhënieve veneto-osmane, të cilat gjatë gjithë ekzistencës së Republikës do të jenë miqësore krahasuar me fqinjët e tjerë të Sinjorisë.

Lufta frontale ndërmjet Venedikut dhe shtetit osman që nisi në vitin 1463 dhe përfundoi vetëm mbas 16 vitesh, më 1479 u zhvillua pikërisht për të rinegociuar statusin e atyre qyteteve të cilat Venediku i kishte marrë nga osmanët përkundrejt pagesës së tributit vjetor. Edhe pse si *casus belli* u përdor një incident kufitar në njërin prej këtyre qyteteve, pra Argosit në More, rinegociimi i statusit ishte bërë i pashmangshëm pikësëpari për shkak të inflacionit të çmimeve. Në se 100 dukatë për një qytet si Shkodra, Drishti, Lezha, Argosi etj., shiheshin si rentë e mjaftueshme në fillim të shek. XV, gjysëm shekulli më vonë në vitet 1460, inflacioni që është një konstante në historinë ekonomike, e bënte të paleverdisshëm për osmanët vazhdimin e marrjes së rentës. Pra, duket se osmanët nuk ishin të kënaqur me ato 100 dukatë për secilin qytet dhe tani edhe për shkak të forcimit të pozitave politike, synonin t'i rimerrnin plotësisht. Lufta e gjatë me osmanët rezultoi mjaft raskapitëse për financat venedikase. Vlera e borxhit qeveritar që negociohej në tregun financiar ra në minimumin e tij historik prej 13 pikësh më 1474. Thesari ishte i boshatisur dhe nuk kishte para as për të paguar rrogat dhe grupe

<sup>32</sup> Në këtë rast venedikasit megjithatë kërkuan që sasia e tributit që paguhej deri atëherë për Drishtin të zbritej nga shuma prej 300 dukatësh sepse Drishti tashmë nuk ishte nën sundimin venedikas, por nën atë serb. “quia locus Drivasti non est amplius sub nostro dominio”. K. Setton, *The Papacy and the Levant...*, f. 30.

<sup>33</sup> D. Romano, *The Likeness of Venice...*, f. 16-17.

<sup>34</sup> Elizabeth A. Zachariadou, “From Avlona to Antalya. Reviewing the Ottoman Military Operations in the 1380s”, në *The Via Egnatia under Ottoman Rule 1380-1699*, edited by Elisabeth Zachariadou, Rethymnon, Crete University Press: 1996, f. 227-232.

rremëtarësh herë pas here protestonin në hyrje të Pallatit Dukal.<sup>35</sup> Megjithë këtë situatë të vështirë, oferta e paqes e paraqitur nga osmanët u refuzua nga Senati më 1476.<sup>36</sup> Në vitin 1477, osmanët filluan të sulmojnë deri në portat e Venedikut, në Friuli. E kërcënuar në dyert e Venecies ashtu si edhe në zotërimet e saj koloniale, në kulmin e vështirësive ekonomike dhe e goditur nga epidemia, Venediku u detyrua të negociojë.

Traktati i paqes i 25 janarit 1479 i hartuar në Stamboll shpall nga perandori në greqisht dhe u soll në Venecie nga i dërguari osman Lutfi Beg dhe më pas u përkthye dhe u miratua edhe nga dogja më 25 prill 1479. Ky traktat formalizon paqen, miqësinë dhe marrëdhëniet mes dy shteteve.<sup>37</sup> Paqja edhe pse rezultoi në humbjen e disa territoreve për Venedikun që u detyrua të lëshojë Negropontin, Argosin, Shkodrën dhe disa zotërimet në More,<sup>38</sup> pati edhe anë pozitive vecanërisht në aspektin e privilegjeve tregtare, pasi autoritetet osmane inkurajuan praninë tregtare venedikase.<sup>39</sup> Traktati trajtonte mes tjerash sigurinë e tregtarëve të dy vendeve (art. 3). Detyrimin e anijeve tregtare dhe të luftës për të ndihmuar njëri-tjetrin në rast nevojë në miqësi e paqe, duke përfshirë edhe bashkëpunimin në kapjen e anijeve korsare e pirate (art. 5). Gjithashtu, me rëndësi është edhe pika që përcakton detyrimin e Venedikut prej 10 mijë dukatësh për të drejtën e tregtisë në territorin osman, megjithatë jo si tribut periodik por si dhuratë, ndryshe nga tributi i paguar nga Raguza që përcaktohet si haraç ose xhizje. Sipas tekstit mes

<sup>35</sup> John Julius Norwich, *Venice: The Greatness and the Fall*, London: Allen Lane, 1981 f. 99.

<sup>36</sup> M. E. Mallett and J. R. Hale, *The Military Organization of a Renaissance State. Venice c. 1400 to 1617*, Cambridge University Press: 1984, f. 8. Kufijtë duhej të shkeleshin nga përfaqësuesit osmanë e venedikas dhe shenjat e kufirit negocioheshin në këtë proces. D. G. Wright, "After the Serenissima and the Grand Turco Made Love: the Boundary Commissions of 1480 & 1482", në *550th Anniversary of the Istanbul University International Byzantine and Ottoman Symposium*, Istanbul: 2004, f. 197-212.

<sup>37</sup> Botuar në greqisht nga Franz Miklosich, J. Muller, *Acta et diplomata graeca Meddi aevi sacra et profana*, vol. III, Vjenë: 1865, f. 295-298; shih edhe Alessio Bombaci, "La Collezione di documenti turchi dell' Archivio di Stato di Venezia", in *Rivista degli studi Orientali*, XXIV, Roma: 1949, f. 95-107.

<sup>38</sup> Venediku obligohej të dorëzonte Shkodrën me të drejtën e banorëve dhe ushtarëve. ("le soldati, e tutti altri homini"). Sinjoria lejohej të tërhiqte çdo material ushtarak pa asnjë pengesë. Artikulli 13 i Traktatit të Paqes.

<sup>39</sup> Ugo Tucci, "Tra Venezia e mondo turco. I mercanti", në *Venezia e i Turchi. Scontri e confronti di due civiltà*, Milano, 1985, f. 38.

dy shteteve do të vendosej mirëbesimi i sinqertë në tokë dhe në det.<sup>40</sup> Një nga pikat më interesante është ajo që përcakton, se në procesin e caktimit të kufijve dhe sovranitetit do të konsiderohen se i përkasin Republikës, territoret të cilat shpallonin flamurin e Shën Markut apo që në të ardhmen do ta shpalosnin, pra do të deklaroheshin si koloni të Venedikut. Mirëpo, problemi u ndërlikua sepse nuk përcaktohej saktë rasti i territoreve që e kishin pranuar sovranitetin venedikas gjatë luftës dhe që përpara fillimit të saj nuk kishin qenë pjesë e kolonive venedikase por as e territoreve osmane. Parimi i marrëveshjes (ahd-name në fakt) ishte që të dy palët do të rikthenin territoret e marra gjatë luftës dhe kufijtë në More, do të riktheheshin në gjendjen dhe vijën e paraluftës (status quo ante bellum). Duke shfrytëzuar këtë paqartësi, po atë vit më 1479, Vlatko, duka i Castel Nuovos dhe Leonard Tocco, despoti i Artës kishin shpaluar flamurin e Venedikut në kështjellat e tyre, me shpresën që të përfitonin nga kjo klauzolë e paqartë për të ruajtur pushtetin e tyre. Megjithatë Venediku nuk e mori përgjegjësinë për aktin e tyre dhe nuk i mbështeti. Ky traktat krahasuar me traktatin e mëparshëm të vitit 1454 është më i detajuar.<sup>41</sup> Natyrisht hiqet krejtësisht pika që përcakton pagesën e tributit prej 300 dukatësh të cilën Venediku i paguante osmanëve për mbajtjen e Shkodrës, Lezhës dhe Drishtit, i reduktuar në 236 dukatë gjatë periudhës kur Drishti ndodhej nën sundimin serb. Traktati cakton edhe mënyrën e dorëzimit të Shkodrës dhe Lemnosit (Staliméni), por nuk trajtohet çështja e Negropontit, Argosit, e Krujës që ishin marrë nga osmanët një vit më parë. Moskthimi i Argosit tek venedikasin shpjegohet pikërisht me faktin që Venediku paguante tribut vjetor për të dhe për pasojë nuk konsiderohej si territor venecian. Mbi moskthimin e Negropontes që nuk u diskutua fare, supozohet gabimisht se marrja e tij nga osmanët ishte

<sup>40</sup> Sipas Diana Gilliland Wright, Pierre A. MacKay, "When the *Serenissima* and the *Gran Turco* made Love: the Peace Treaty of 1478", *Studi veneziani*, 53, Venezia: 2007, f. 262, 'make love' është përkthimi i fjalëpërfjalshëm i termit greqisht të përdorur në ahd-name, πῆσαι νέαν ἀγάπην.

<sup>41</sup> Botuar nga Samuele Romanin, *Storia documentata di Venezia*, vol. IV, Venezia: 1885, f. 261. Njëra pjesë konfirmon pikat e traktatit të 23 shkurtit 1446 dhe pjesa e dytë përmban artikuj të rinj. F. Babinger, F. Dölger, "Mehmed's II. frühester Staatsvertrag (1446)", në *Orientalia Christiana Periodica*, XV, Roma: 1949, f. 225-258; po ashtu A. Bombaci, "Due clauseole del trattato in greco fra Maometto II e Venezia, del 1446", në *Byzantinische Zeitschrift*, 43, Stuttgart: 1950, f. 267-271.

hakmarrje personale e Sulltanit për sulmin e Ainos nga Nicolo da Canale.<sup>42</sup>

Venediku u detyrua, simbas paqes, të rikthejë tek osmanët territoret e marra gjatë luftës në More.<sup>43</sup> Kështjella e Vatikës afër Malvasisë u kontestua. Këtë fortesë e kishte pasur katalanasi Lope de Baldaga dhe më pas e marrin venedikasit më 1462. Osmanët nuk e njohën legjitimitetin e zotërimit venedikas dhe të sunduesit të mëparshëm të saj, duke pohuar se kishte qenë pjesë e despotatit të Moresë dhe si e tillë duhej të kalonte në zotërim osman si territor i fituar me luftë. Është për t'u theksuar se perandori osman zotohet se do t'i kthejë të gjitha territoret që ia kishte marrë Venedikut dhe që do të duhej të rivendosej kufiri që të dy shtetet kishin përpara luftës.<sup>44</sup> Në këtë aspekt duket se të dy shtetet i konsideronin territoret shqiptare të Shkodrës, Lezhës, Drishtit dhe Krujës si territore të cilat nuk i kishin përkatur Venedikut.<sup>45</sup>

Marrëdhëniet diplomatike mes Venedikut dhe Perandorisë Osmane mbas nënshkrimit të paqes dhe deri në vdekjen e perandorit Mehmeti II më 3 maj 1481, janë shumë të dendura dhe përcaktojnë në vija të përgjithshme marrëdhëniet e dy shteteve deri në fundin e Republikës.<sup>46</sup> Pika më e rëndësishme dhe më e vështirë e normalizimit të këtyre marrëdhënieve ndërkohë rezultoi përcaktimi i kufijve ballkanikë mes dy

<sup>42</sup> K. Setton, *The Papacy and the Levant...*, vol. II, f. 293.

<sup>43</sup> Ferma greqisht i 23 shtatorit 1479 në ASV, CDT, Busta XVIII bis, botuar nga A. Bombaci, "Nuovi firmani greci di Maometto II", *Byzantinische Zeitschrift*, nr. 47, (Stuttgart 1954), f. 300.

<sup>44</sup> Në dokumentet e Sulltan Mehmetit II drejtuar dogjës theksohet gjithnjë dallimi mes qyteteve që venedikasit ua kishin marrë osmanëve gjatë luftës dhe atyre të cilat venedikasit i kishin marrë nga zotër të tjerë. Kështu në letrën e 24 majit 1571 drejtuar dogjës Cristoforo Moro, Mehmeti II pranon që venedikasve t'u mbetet Malvasia që e kishin marrë nga katalanët, por jo Kruja. "remanendo a vui maluasia laqual avuiti tolto dal mano de alt(ri) e similit(er) debiati restituiri anui Croia occupata p(er) vui dapo lamorte de schender. dello resto ueramente ogni una delle p(ar)te tengna quello ch(e) allo presente tene e possede." ASV, Procuratori di San Marco, busta 161; V. L. Ménage, "Seven Ottoman Documents...", dok. nr. 1, i datës 24 maj 1471.

<sup>45</sup> Për Krujën Mehmeti II ia bën të qartë Sinjorisë se pushtimi i Krujës nga trupat venedikase pas vdekjes së Skënderbeut ishte i pavlefshëm. V. L. Ménage, "Seven Ottoman Documents"..., dok. nr. 1, f. 82, 4 maj 1471.

<sup>46</sup> K. Setton, *The Papacy and the Levant...*, vol. 2, f. 328.

shteteve.<sup>47</sup> Përmes marrëveshjes së paqes dhe negociatave të mëvonshme Mehmeti II përveç që kishte rimarrë territoret osmane që ishin mbajtur nga Venediku në këmbim të tributit vjetor si Shkodra, Lezha e Drishti, ashtu edhe Krujën e marrë prej venecianëve gjatë periudhës së luftës, pra të cilën marrëveshja e paqes e bënte të paligjshëm, kishte zgjeruar zotërimet e veta përmes eliminimit të disa sundimtarëve të vegjël si Vlatko sundues i Castelnuovos dhe Ivan Crnojevic, sundimtar në Mal të Zi, si edhe Leonardo di Tocco despot i Artës. Venediku edhe pse u detyrua t'ia rikthente osmanëve territoret e Shqipërisë Veriore dhe të Egjeut për të cilat paguante tribut, u pajtua edhe me këto zgjerime të vogla osmane në Ballkan, edhe për faktin se për të ishte njëfarë frenimi i synimeve aragoneze në lindje. Rivaliteti veneto-aragonez shtrihej edhe në Ballkan, pasi përvec mbesës së Frederikut që ishte martuar me Vlatkon, një tjetër mbesë e tij ishte martuar me Leonardo Tocco. Prandaj, kur një nip i Ivan Crnojevicit u ndihmua nga Ferdinandi i Aragonit me një anije që të rikthehet në Mal të Zi, Sinjoria e informon Mehmetin II që Ivan Crnojevic po planifikonte të kthehej në zotërimet e humbura me ndihmën e mbretit Ferdinand.<sup>48</sup> Në këto kushte, Mehmeti II ngarkon Ahmed Gedik Pashën që të marrë zotërimet e Tocos dhe flota venedikase urdhërohet që të mos i sjellë asnjë pengesë operacioneve osmane. Në gusht 1479, mbërrin një emisar i dërguar nga Ahmet Gedik Pasha, sanxhakbe i Vlorës që deklaroi miqësinë e tij me Venedikun dhe thekson faktin se vetëm Papa dhe Ferdinandi i Napolit ishin kundërshtarët e tij. Gjithashtu ai kërkon që Sinjoria t'i dorëzojë fortesat e Sopotit dhe Himarës të cilat ai pohon që i përkisnin perandorisë.<sup>49</sup> Më 23 gusht, Senati përgjigjet se nuk kishte arsye t'i konsideronte armiq papatin dhe Napolin, ndërsa lidhur me fortesat e Himarës dhe Sopotit, Senati me takt ia lë në dorë negocimit direkt me Stambollin dhe jo me qeveritarin shqiptar.<sup>50</sup> Përmes një letre të dërguar nga negociatori Trevisan më 23 shtator, Mehmeti II pohon respektimin e marrëveshjes së paqes dhe cakton si përfaqësues për delimitimin Emirin Halil. Gjithashtu, sulltani mban anën e shqiptarit dhe

<sup>47</sup> Aldo Gallotta, "Venise et l'Empire ottoman, de la paix du 25 janvier 1479 à la mort de Mahomet II, 3 mai 1481", në *Revue de l'Occident musulman et de la Méditerranée*, n. 39, Paris: 1985, f. 113-130.

<sup>48</sup> Alessio Bombaci, "Venezia e l'impresa turca di Otranto", në *Rivista Storica Italiana*, LXVI, Napoli: 1954, f. 175-176.

<sup>49</sup> Po aty, f. 196-197.

<sup>50</sup> K. Setton, *The Papacy and the Levant...*, vol. 2, f. 340-341.

kërkon zyrtarisht dy fortesat.<sup>51</sup> Në tetor, Ahmed Gedik Pasha drejtohet me forcat e tij kundër ishullit të vogël të Bastias (Sajadhës) afër Korfuzit, të cilën e bastis, me synimin për të krijuar një zonë sigurie në kufi. Më 23 nëntor 1479, Senati udhëzon bailiun Gritti që të protestojë butësisht për veprimet e mbrapshta të Ahmed Gedik Pashës në Bastia, la Rilla, të zotëruara nga venedikasit prej më se njëqind vitesh. Shqiptari i përgjigjet se aksioni i tij duhej marrë si veprim i atij që hyn në bahçen e një miku të vet që dëmton diçka por pa të keq, mbasi kryezoti i tij ishte mik i venedikasve.<sup>52</sup>

### Përvijimi i parë i kufijve

Megjithë caktimin e komisionerit venedikas për caktimin e vijës kufitare roli i tij ishte inferior në krahasim me komisionerin osman, mbasi vija kufitare në fakt më tepër ishte e imponuar se sa e negociuar. Natyrisht fitorja e luftës ua jepte osmanëve këtë superioritet faktik në rregullimet e pasluftës. Këtë situatë e shfrytëzojnë qeveritarët lokalë, veçanërisht sanxhakbejtë e Vlorës e të Shkodrës për të zgjeruar sundimin e tyre në zonat e diskutuara të kufirit. Emiri Halil në cilësinë e komisionerit osman për delimitimin e kufijve gjatë gjithë periudhës së aktivitetit të tij nga tetori 1479 deri në shkurt 1480 ishte më tepër në rolin e mbikëqyrësit të zbatimit të marrëveshjes së paqes se sa të negociatorit. Ndërkohë që Mehmeti II njihte kufijtë e paraluftës për zonën e Splitit, më e vështirë paraqitej situata në zonën e Kotorrit, kryesisht për kriporet e Zhupës së Grbalit dhe fshatrat që kishin qenë zotërime të Pastrovicëve. Osmanët i kërkonin këto territore si pjesë e zotërimeve të Ivan Crnojevicit që kishin kaluar në zotërimin osman. Ndërsa, Venediku mbështeste pretendimet e veta në tri bularta të mbretërve serbë dhe theksonte se Crnojevici i kishte zotëruar këto territore vetëm përkohësisht gjatë luftës dhe se Patrovicët i kishte nënshtruar pa dëshirën e tyre.<sup>53</sup> Më

<sup>51</sup> A. Bombaci, "Nuovi firmani greci...", f. 300.

<sup>52</sup> Kontantinos N. Sathas, *Documents inédits relatifs à l'histoire de la Grèce au Moyen Age publiés sous les auspices de la Chambre des députés de Grèce*, vol. VI, Venezia: 1885, f. 217.

<sup>53</sup> *Dokumenta të shekullit XV për Historinë e Shqipërisë*, vëll. IV (1479-1506), Pjesa I (1479-1499), përgatiti për botim Injac Zamputi, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë e Gjuhësisë, Tiranë: 1967, dok. nr. 43, f. 46, 17 nëntor 1479. Mehmeti II i shkruan Sinjorisë rreth kufijve dhe përmend Himarën, Sopotin, Tivarin, tokët e Cernojeviqëve, Vlorën dhe limanin e saj.

19 janar 1480 komisioneri venedikas Gritti udhëzohet që për zonën e Tejbunës të mbronte qëndrimin se qytetet nuk mund të mbijetojnë pa rrethinat e tokat e tyre. Në rast të fundit mund të lëshonte pe për Krajën edhe pse ajo i përkiste Tivarit dhe jo Shkodrës.<sup>54</sup> Ndërkohë caktimi i vijës kufitare në Budva, Tivar e Ulqin ishte edhe më i rëndësishëm për të dy palët. Simbas një marrëveshjeje të hershme mes dy shteteve me rikthimin e Shkodrës nën sovranitetin osman Venediku kishte pranuar vijën e vjetër kufitare që njihte Bunën si kufi. Mirëpo ndërkohë që të dy shtetet binin dakord për rikthimin e territoreve të Shkodrës të cilat osmanët ua kishin lëshuar venedikasve kundrejt pagesës që në fundin e shek. XIV, Mehmeti II në një letër zyrtare të 19 shtatorit 1479 kërkonte edhe disa zona përtej Bunës deri në det që ua kishte marrë venedikasve gjatë luftës, simbas të drejtës së fitimit me luftë.<sup>55</sup> Arsyetimet e Venedikut synonin që të garantonin një vazhdimësi territoriale ndërmjet të tri qyteteve dhe Emiri Halil ua njohu zotërimin e qyteteve të Ulqinit e Tivarit. Nga Shkodra komisioneri osman u zhvendos sërish në More. Sanxhakbeu i Moresë, Sulejman Pasha, kërkonte fushat pjellore përreth fortesave të Thermis e Castri që i kishte marrë si timar personal. Mirëpo në procesin e caktimit të vijës kufitare venedikasit tregojnë një marrëveshje të vitit 1394. Përkundër këtij dokumenti osmanët sjellin në mbështetje të interesave të tyre defterët e mëparshëm si edhe një letër të Sulltanit të interpretuar më shumë në favor të sanxhakbeut.<sup>56</sup>

### **Delimitimi i dytë i kufijve**

Misioni i Halil Begu i kishte lënë venedikasit shumë të pakënaqur.<sup>57</sup> Më 8 mars 1480, mbërrin në Venecia i dërguari tjetër i perandorit Hasan Begu, që sillte katër letra prej Mehmetit II të datuara 7 janar.<sup>58</sup> Në to, Mehmeti II kërkonte sërish shkatërrimin e fortesës së Galatës në Lepant dhe pohonte sërish të drejtat e tij të fitimit me luftë të territoreve të Tejbunës duke njoftuar se kishte udhëzuar sanxhakbeun e Shkodrës që të ndëshkojë nënshtetasit venedikas të cilët nuk respektonin vijën kufitare të

<sup>54</sup> A. Gallotta, "Venise et l'Empire ottoman...", f. 120.

<sup>55</sup> *Dokumenta të shekullit XV për Historinë e Shqipërisë ...*, vëll. IV, pjesa I, dok. nr. 47, f. 48-49, 7 janar 1480. Mehmeti II sërish nuk pranon t'ua lërë venedikasve bregun e djathtë të Bunës, por shumë-shumë të lejojë një ndreqje të kufirit.

<sup>56</sup> A. Gallotta, "Venise et l'Empire ottoman...", f. 123.

<sup>57</sup> Po aty, f. 124.

<sup>58</sup> Botuar nga A. Bombaci, "Nuovi firmani...", f. 308-311.

caktuar nga Emiri Halil në zonën e Kotorrit, Ulqinit dhe Tivarit.<sup>59</sup> Ndërkohë, Venediku informohet se sanxhakbeu i Shkodrës kishte bastisur rrethinat e Tivarit dhe kishte rivendikuar sovranitetin mbi banorët e atyre rrethinave. Perandori i njëjti të drejtën Venedikut për shfrytëzimin e disa peshkoreve në Epir, duke e falënderuar Sinjorinë për informatat e dhëna mbi manovrat e Ivan Crnojevicit. Në lidhje me kufirin në Shqipëri, Senati u përgjigj se do të caktonte një komisioner.<sup>60</sup> Mehmeti II pranon rishikimin e kufijve në favor të Venedikut në Tivar e Ulqin, dhe në More. Këtë radhë komisioner osman caktohet Sinan Beg, sanxhakbe i Greqisë, i cili dëshmohet mjaft dashamirës ndaj Sinjorisë. Gjatë gushtit komisionerët osmanë e venedikas caktojnë kufijtë në More.<sup>61</sup> Në nëntor komisionerët mbërrijnë në Shkodër. Mirëpo, ndërsa në More komisioneri osman kishte favorizuar venedikasit edhe duke marrë rryshfet, në Shkodër hasi në kundërshtimin e rreptë të sanxhakbeut. Për Ulqinin e Tivarin si pasojë nuk arrihet një marrëveshje, ndërsa Budva, Kotori mbetën sërish pezull.<sup>62</sup>

### **Caktimi i tretë i kufirit**

Në dhjetor 1481, Senati i jep udhëzime të reja oratorit Cocco, për të kërkuar kufij më të favorshëm në More dhe në Ulqin një kufi që të nisë nga bregu i detit dhe që hyn në thellësi. Delta duhej t'i mbetej Ulqinit ndërsa fshatrat e Shirgjit, Fegi e Shënkolli t'i njiheshin Shkodrës si edhe një zgjerim të kufirit në Tivar përkundër atij të propozuar nga Emiri Halil. Përmes një fermi të datës 30 prill Mehmetit II cakton kufijtë sipas propozimeve të komisionerit Sinan Begu duke i njohur Venedikut në Kotorr, Zhupën me zotërimet e Pastrovicëve, në Tivar 7 fshatra të kërkuara nga Venediku dhe në Ulqin, tri fshatra. Githashtu, edhe në More kërkesat e venedikasve gjetën një përmbushje të kënaqshme.<sup>63</sup>

<sup>59</sup> F. Miklosich, J. Muller, *Acta et diplomata graeca...*, vëll. III, f. 293-295.

<sup>60</sup> A. Gallotta, "Venise et l'Empire ottoman...", f. 121-122.

<sup>61</sup> K. Sathas, *Documents inedits...*, VI, f. 141-147; *Dokumenta të shekullit XV për Historinë e Shqipërisë ...*, vëll. IV, pjesa I, dok. nr. 56, f. 54, 3 gusht 1480. Sinan Beu nisët për të vendosur kufijtë midis zotërimit turk dhe venedikas.

<sup>62</sup> K. Sathas, *Documents inedits...*, VI, f. 220.

<sup>63</sup> *Dokumenta të shekullit XV për Historinë e Shqipërisë ...*, vëll. IV, pjesa I, dok. nr. 72, f. 66, 30 prill 1481. Sulltani i shkruan Sinjorisë rreth kufijve dhe flet për tokat e Cernojeviqit, Ulqinin dhe Tivarin, duke u lënë venedikasve tokën e Pastrovicëve; A. Gallotta, "Venise et l'Empire ottoman...", f. 127-128.

### Mosmarrëveshje të reja në fund të shek. XV

Sanxhakbejtë e Vlorës dhe Shkodrës që nga fundi i luftës veneto-osmane dhe gjatë gjithë bisedimeve të përcaktimit të kufijve ishin përpjekur të luanin një rol aktiv me synim zgjerimin e kufijve të provincave të tyre. Në këtë aspekt shquhen Gedik Pasha, sanxhakbeu ambicioz i Vlorës në fillimin e viteve 1480 dhe Sanxhakbeu i Shkodrës, Feris Beu në fund të viteve 1490. Në synimet e tyre natyrisht që ishin në kontakt me Portën e Lartë, mirëpo në të njëjtën kohë ushtronin presion në kufijtë e zotërimit të tyre për shtrirje sa më të madhe.<sup>64</sup> Në këtë përpjekje, Feris Beu dërgon edhe emisarët e vet në Venedik për të kërkuar me këmbëngulje tokat që synonte. Sic e kuptonin edhe venedikasit Feris Beu kërkonte një justifikim për të arritur synimet edhe përmes forcës, duke dërguar agjentë për të matur pulsën e Sinjorisë.<sup>65</sup> Edhe venedikasit ishin të informuar me sa duket për këtë liri veprimi të sanxhakbeut prandaj Senati venedikas i merrte me shumë seriozitet kërkesat e Feris Beut dhe u rezervonte respektin maksimal të dërguarve të tij. Sanxhakbeu shkodran shkonte deri aty sa të sponsorizonte incidente kufitare me qëllim fajësimin e venedikasve në sytë e Portës dhe mbajtjen e situatës së tensionuar.<sup>66</sup> Sanxhakbeu i Shkodrës në fakt ishte kthyer në një aktor politik që i tejkalonte marrëdhëniet me Venedikun.<sup>67</sup> Në kushtet e rihapjes së çështjes së kufijve dhe përballë kërcënimeve të flamurtarëve shqiptarë çdo lëvizje e forcave osmane vigjilohej dhe shihej me

<sup>64</sup> “*Ferisbech sanzacho di Scutari... vol venir a parlarli per raxon di certi confini; et par vogli meter novi termini che saria la ruina di Dulzigno*”. *I Diari di Marino Sanuto*, per cura di G. Berghet, tomo II, Venezia: 1879, f. 698.

<sup>65</sup> “*ha mandà ditto suo messo qui, etiam per spiar le cosse di Italia*”. *Po aty*, 8 mars 1499, f. 951.

<sup>66</sup> “*esso sanzacho l’habi fato amazar per trovar causa di far mal contra la Signoria nostra incolpando quella*”. *Po aty*, 20 maj 1499, f. 1399. Francesco Zigogna rektor i Kotorrit, megjithatë pohonte “*che il sanzacho di Scutari Ferisbei ch’è homo da ben... et era molto amico di la Signoria nostra*”. *Po aty*, 8 nëntor 1498, f. 198.

<sup>67</sup> Një anije nga Trieste e ngarkuar me drithëra e nisur nga Pesaro kishte mbërritur në grykën e Bunës dhe në të ndodhej edhe një orator nga Milano që shkonte në Shkodër. “*per andar a Scutari uno secretario dil ducha di Milan*”. *Po aty*, 22 korrik 1499, f. 1800.

shqetësim e frikë. Kjo kishte edhe arsyen e vet mbasi incidentet kufitare nuk munguan gjatë gjithë kësaj periudhe.<sup>68</sup>

### Në përfundim

Mund të themi se nga këndvështrimi i traktateve të paqes mes aktorëve politikë përcaktues në trojet shqiptare gjatë shek. XIV-XV rezulton se kufijtë mes fuqive politike të huaja që faktorizohen në këtë periudhë në këtë hapësirë politike, Republikës së Venedikut dhe shtetit osman, vendosen qartësisht në dekadën e fundit të shek. XIV dhe qëndrojnë në aspektin formal të pandryshuar deri në fundin e shek. XVI. I vetmi ndryshim që rezultoi nga lufta mes Venedikut dhe osmanëve në vitet 1463-1479, ka të bëjë më tepër me ndryshimin e statusit të territoreve të përfshira në kufijtë e vendosur që në vitet 1390, se sa me ndonjë ndryshim thelbësor të vijës kufitare. Territoret e Balshajve përbëjnë bërthamën më të rëndësishme politike ku u shpалosën më qartazi marrëdhëniet dhe rivalitetet mes tyre në shek. XV. Këto territore u ndanë në dy pjesë. Njëra pjesë që merret nga osmanët më 1393, me kryeqendër Shkodrën mbetet *de jure* gjithnjë si zonë e mbisundimit osman, ndërsa de fakto nga 1396 e deri më 1479 ishte zonë e sundimit venedikas. Në vitin 1479, osmanët e morën edhe *de facto* këtë pjesë të zotërimeve të dikurshme të Balshajve. Pjesa tjetër e këtyre zotërimeve, të cilën osmanët nuk e morën asnjëherë nga Balshajt, pra, pjesa bregdetare e Ulqinit, Budvës dhe Tivarit, u mor në vitin 1405 nga venedikasit drejtpërdrejt nga Balshajt dhe osmanët ua njohën zotërimin e kësaj pjese venedikasve *de jure* dhe *de facto* dhe për pasojë u përjashtuan si nga konflikti i viteve 1463-1479 ashtu edhe nga rregullimet e paqes që e pasoi. Në këtë mënyrë kufiri mes dy pjesëve të zotërimeve të copëtuara të Balshajve u shndrrua në vija të përgjithshme në kufi mes venedikasve dhe osmanëve në Shqipërinë Veriore për dy shekuj me radhë, pra, nga ndarja e viteve 1393-1396 dhe 1405 e deri në vitin 1571.

---

<sup>68</sup> “*turchi di Scutari 200 et 300 paesani veneno a le sbare, et quelli di la terra ussiteno fuori a le man, amazono 5 turchi, molti feriti, et 10 cavali de' nostri, uno solo fu morto*”. *Po aty*, 12 gusht 1499, f. 2039.

*S u m m a r y*THE ESTABLISHMENT OF VENETIAN-OTTOMAN BORDER IN THE SHKODRA  
SANJAK AT THE END OF THE XV CENTURY ACCORDING TO THE INTERNATIONAL  
TREATIES OF THE TIME

In this article we analyse the negotiations and delineation process of political borders between the Ottoman State and the Republic of Venice at the end of the fifteenth century, according to the international peace treaties of the time. The analysis shows that the borders between these two states, that will share this political space for centuries, are clearly set in the last decade of the fourteenth century and will stay formally unchanged until the end of the sixteenth century. The only change resulting from the war between Venice and the Ottomans in the years 1463-1479, has to do with the change of the status of the territories involved in the borders established since the 1390s, rather than with any substantial changes in the borderline. The Balsha territories constitute the most important political nucleus where the relations and rivalries between the Ottomans and the Venetians were more explicitly disclosed in the fifteenth century. From the onset of their presence in the region, these territories were divided into two parts. One part taken by the Ottomans in 1393, with the capital of Shkodra, remains *de jure* ever as an Ottoman domination zone, while *de facto* from 1396 to 1479 was a Venetian rule zone. In 1479, the Ottomans took *de facto* this part of Balsha's former possessions. The rest of these possessions, which the Ottomans never took from the Balshas, the coastal part of Ulcinj, Budva and Tivar, was taken in 1405 by the Venetians directly from the Balshas. The Ottomans recognized the possession of this part by Venice *de jure* and *de facto* and consequently these territories were excluded from the conflict of 1463-1479 and from the peace arrangements that followed. Thus, the boundary between the two parts of the fragmented Balsha's possessions was transformed into general boundaries between the Venetians and the Ottomans in Northern Albania for two centuries, from the separation of the 1393-1396 and the 1405 to the year 1571.